



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:005239

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441307

P.nr.241/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Erzana Hameli- Mustafa, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.Ç., nga fshati Tupec, Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 182 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren- Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.7-15/2024 të datës 28.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në seancë publike, në praninë e prokurorit të shtetit Musli Gashi, të pandehurit E.Ç., me mbrojtësin e tij av.B.P., nga Prizreni më datë 01.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari :

E.Ç., me nofkën, nga i ati, e ëma, e lindur, i lindur më datënë Prizren, tani me banim në fshatin Tupec, Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion furrtar, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 30.12.2023, rreth orës 19:05minuta, në rrugën “Viliam Wolker” në Prizren, saktësisht pran kompleksit banesor Kabashi, i pandehuri përfshihet në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme, përkatësisht komunikon me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit të personit tjetër dhe atë më të dëmtuarës S.K., në atë mënyrë që, i pandehuri ditën kritike nga parku/ oborri të kompleksit banesor i shkon nga pas të dëmtuarës duke e përcjell deri ne hyrje te banesës- korridor dhe deri sa e dëmtuara e pret ashensorin i pandehuri fillimisht i drejtohet me fjalët “*jam tu te përcjell*” duke vazhduar me pas “*jam tu të prit , hyn ne lifte se t’i kapa flokët*”, dhe kur e dëmtuara refuzon ti bindet kanosjes së të pandehurit duke e marr telefonin për të kërkuar ndihme, i njëjti deri sa po logohej i drejtohet te dëmtuarës me fjalët “*hajt se te zo*”, ashtu që vendos kapelën në kok dhe largohet me vrap në drejtim të panjohur, me ç’rast me këto veprime me qëllim të ngacmimit ka shkaktuar shqetësim të madhe emocional të përcjellë me ankth dhe emocione tek e dëmtuara.

Këso dore ka kryer veprën penale ngacmimi nga neni 182 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 38,39, 40, 43, 44 69,70 nenit 182 par 1 të KPRK-së dhe nenit 364 të KRPPK-së nr. 08/L-032 (KPP), të akuzuarin :

GJYKON

Për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të akuzuarit i shqipton **dënim me gjobë në shumë prej 1500 € (njëmijë e pesëqindën) euro, në të cilën shumë do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 04.01.2024 deri më datë 01.03.2024, gjithsej 58 ditë**, Ashtu që për çdo ditë të kaluar nën masë do të hiqen nga 20 € (njëzet) euro, nga dënimi me gjobë. Ndërsa pjesa e mbetur e dënimit me gjobë në lartësi **prej 340 € (treqind e katërdhjetë) euro**, duhet të paguhet në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € (njëzet) euro llogaritet 1 (një) ditë burgim

E dëmtuara S.K-K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest te rregullt juridike- civile.

I akuzuari OBLIGOHET që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro si dhe në emër të kompensimit të viktimave, të paguaj shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën, PP/II. nr. 7-15/2024 të datës 28.02.2024, ndaj të akuzuarit E.Ç., nga fshati Tupec, Komuna e Prizrenit, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale ngacmimi nga neni 182 par 1 të KPRK-së.

Pas pranimit të shkresave të lëndës gjyqtari i vetëm gjykues, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor më datë 01.03.2024, në të cilin shqyrtim, i akuzuari E.Ç., pas udhëzimeve lidhur me të drejtat të cilat u takojnë, sipas ligjit, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, e ka pranuar fajësinë që ngarkohet me aktakuzë.

Prokurori i Shtetit Musli Gashi gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, me pranimin e fajësisë në tërësi vërtetohet gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës me këtë edhe fakti se i pandehuri E.Ç., ka kryer veprën penale ngacmim nga neni 182.par.1. të KPRK-së nr. 06/L-074.

Mbrojtësi i të pandehurit E.Ç., – av. BP., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se pas pranimit të fajësisë nga i mbrojturi im nuk më mbetet gjë tjetër të shtoj përveç faktit që e lus gjykatën që të mbrojturit tim të i shqiptoj një dënim sa më të but kjo nga fakti se i mbrojturi

im nuk ka të kaluar kriminale, është hera e parë që bie ndesh me Ligjin, ka qenë korrekt gjatë gjithë fazave të procedurës, në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë, është penduar për veprimet lidhur me shqetësimet e palës së dëmtuar, ka kërkuar falje në mënyrë publike dhe njëherit ka premtuar dhe premtton përsëri se veprimet e tilla nuk përsëriten andaj mbi këto baza i propozoj gjykatës që të mbrojturit tim të i shqiptohet një dënim me gjobë pasi që në shqiptimin e gjobës do të arrihet edhe qëllimi i dënimit ngase i njëjti gjatë kohës së qëndrimit në masën e paraburgimit për dy muaj ka kuptuar në tërësi dhe është pregaditur që në të ardhmen mos të përsëriten veprime të tilla, gjithashtu i propozoj gjykatës ndërprerjen e masës së paraburgimit pasi që i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe nuk ka bazë ligjore për ta mbajtur në paraburgim të njëjtin.

I akuzuari E.Ç., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar pranon fajësinë vullnetarisht për veprën penale për të cilën jam i ngarkuar si në aktakuzë duke theksuar se jam penduar për një veprim të tillë, kam gabuar për këtë veprim, shprehi kërkim falje ndaj të dëmtuarës, kjo ka ndodhur nga momenti i çastit dhe në mënyrë të pa qëllimtë, me të dëmtuarin kurrë më parë nuk kemi pasur probleme as që e kam njohur më parë, është herë e parë që kam ra ndesh me Ligjin, jam i pa punë, është hera e parë dhe e pa qëllimet që është bërë një veprim të tillë, premtoj dhe zotohem se në të ardhmen më kurrë nuk do të përsërisë një veprim të tillë, e lus gjykatën që deklarata ime të mirët si rrethanë lehtësuese në shqiptim të dënimit sa më të but.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pranimin e fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet dhe provat të cilat i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose faktike .

Gjyqtari i vetëm gjykues në shqyrtimin fillestar pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarin i njoftuar palët mbi seancën mbi dënimin konform nenit 356 të KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar se heq dorë nga seanca e veçantë mbi dënimin, kështu që gjykata ka proceduar me shpalljen e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike me datë 30.12.2023, rreth orës 19:05minuta, në rrugën “.....” në Prizren, saktësisht pran kompleksit banesor Kabashi, i pandehuri përfshihet në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme, përkatësisht komunikon me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit të personit tjetër dhe atë më të dëmtuarës S.K-K., në atë mënyrë që, i pandehuri ditën kritike nga parku/ oborri të kompleksit banesor i shkon nga pas të dëmtuarës duke e përcjell deri ne hyrje te banesës- korridor dhe deri sa e dëmtuara e pret ashensorin i pandehuri fillimisht i drejtohet me fjalët “*jam tu te përcjell*” duke vazhduar me pas “*jam tu të prit , hyn ne lifte se t’i kapa flokët*”, dhe kur e dëmtuara refuzon ti bindet kanosjes së të pandehurit duke e marr telefonin për të kërkuar ndihme, i njëjti deri sa po logohej i drejtohet te dëmtuarës me fjalët “*hajt se te zo*”, ashtu që vendos kapelën në kok dhe largohet me vrap në drejtim të panjohur, me ç’rast me këto veprime me qëllim të ngacmimit ka shkaktuar shqetësim të madhe emocional të përcjellë me ankth dhe emocione tek e dëmtuara.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, për shkak të së cilës

gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata konform nenit 251 të KPPRK-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas ligjit.

Kështu, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së dhe faktet që përmban aktakuza, dhe se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale ngacmimi nga neni 182 par 1 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovës, për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprkisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese për të akuzuarin E.Ç., gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, kërkim faljen dhe pendimin Ndërsa, si rrethanë rënduese gjykata ka marrë natyrën dhe llojin e veprës penale, rrezikshmërinë e veprës penale, dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla të kundërligjshme dhe se ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale u mor në kuptim të nenit 449 dhe 452 par. 1. të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të Ligjit nr.08/L-109.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2024:005239, 01.03.2024

**B.Profesional
Erzana Hameli- Mustafa**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Gani Kastrati**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.